



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

Nr. 11262 Prot. Datë 27/11/2014

Nr. 7398/1 Prot. Datë 22/12/2014

URDHËR

11262, date 27.11.2014

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA ZHURMAT
NGA AVIACIONI CIVIL”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, Ligjin nr.9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, pika 2 e nenit 56, të Ligjit 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i RSH-së”, të ndryshuar, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Mjedisit,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e mjedisit nga zhurmat nga aviacioni civil” sipas tekstit të rregullores bashkëlidhur këtij Urdhëri.
2. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

MINISTRI

Lefter KOKA



MINISTRI

Edmond HAXHINASTO



RREGULLORE

E MINISTRIT TË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS DHE MINISTRIT TË MJEDISIT "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA ZHURMAT NGA AVIACIONI CIVIL "¹

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Rregullorja ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga zhurmat e aviacionit civil duke përcaktuar rregullat për operimin e avionëve civil reaktiv subsonik në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me standartet e zhurmave nga avionët.

Neni 2

Objekti

1. Kërkesat e kësaj rregulloreje zbatohen nga :

- a. Avionët, që kanë një kapacitet maksimal shkëputjeje nga toka 34 000 kg ose më shumë;
- b. Avionët, që kanë një akomodim të brendshëm maksimal të çertifikuar sipas tipit të avionit, me më shumë se 19 vende për pasagjerë, duke përjashtuar vendet e ekuipazhit.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim me ato të dhënë në Ligjin 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i RSH-së", i ndryshuar, ndërkohë për qëllim të këtij vendimi termi: "Avionë civil reaktiv subsonik" ka kuptimin e avionëve me një masë maksimale në ngritje (maximum takeoff mass) prej 34 000 kg ose më shumë, ose me një akomodim maksimal të brendshëm të çertifikuar për llojin e avionit në fjalë, të përbërë nga më shumë se 19 vende të pasagjerëve, me përjashtim të vendeve të anëtarëve të ekuipazhit.

KREU II MENAXHIMI I ZHURMËS

¹ Kjo rregullore pjesërisht përaftron:

- Direktivën nr. 89/629/EEC e datës 4 Dhjetor 1989 mbi kufizimin e emetimeve të zhurmave nga avionët civil reaktiv subsonik, CELEX:31989L0629, OJL 363, 13.12.1989;
- Direktivën Nr. 2006/93/EEC, e datës 12 Dhjetor 2006, mbi rregulloren e operimit të aeroplanëve që përfshihen në Pjesën II, Kapitulli 3, Volumi 1 i Aneksit 16 të Konventës së Aviacionit Ndërkombëtar Civil, CELEX: 32006L0093, OJL 374/2 , 76/12/2006;

Neni 4

Autoritetet kompetente

Autoriteti i Aviacionit Civil është autoriteti përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregullore me anë të :

1. Lëshimit të çertifikatës së zhurmave për avionët e regjistruar në Republikën e Shqipërisë,
2. Kontrollit, nëse avionet e regjistruar kanë çertifikatën e duhur të zhurmave dhe nëse avionët që aplikojnë për të hyrë në aeroportet kombëtare plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Ligjin 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i RSH-së”, i ndryshuar.

Neni 5

Çertifikata e zhurmave

1. Të gjithë avionët civil reaktiv subsonik të regjistruar në regjistrin e avionëve civilë të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Ligjin 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i RSH-së”, i ndryshuar, janë të detyrar të pajisen me Çertifikatën për Zhurmat.
2. Të gjithë avionët civil reaktiv subsonik, të regjistruar në shtete të tjera dhe që kanë destinacion aeroportet e Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë të pajisur me Çertifikatën për Zhurmat, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare (Pjesa II, Kapitulli 3, i Aneksit 16, të Konventës së Aviacionit Ndërkombëtar Civil).
3. Çertifikata e zhurmave për avionët civil reaktiv subsonik në aeroportet e Republikës së Shqipërisë, lëshohet në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i RSH-së”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 6

Përfashtime nga pajisja me çertifikatën e zhurmave

1. Autoriteti i Aviacionit Civil, mund të bëjë përfashtime nga kërkesat e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, për avionët me interes historik.
2. Autoriteti i Aviacionit Civil, i raporton Ministrin përgjegjës për Transportet për çdo përfashtim të bërë sipas pikës 1 të këtij neni edhe arsyen e këtij përfashtimi.
3. Autoriteti i Aviacionit Civil njih përfashtimet e dhëna në një shtet anëtar të BE-së ose një shtet palë në marrëveshjen shumëpalëshe për krijimin e zonës europiane të përbashkët të aviacionit për avionët e regjistruar në këto shtete.
4. Autoriteti i Aviacionit Civil, lejon përdorimin në mënyrë të përkohshme të aeroplanëve që gjenden në aeroportet e territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk mund të operojnë bazuar në parashikimet e kësaj rregulloreje, për rastet e mëposhtme:

- a. aeroplanet, operimi i të cilëve është i një natyre të jashtëzakonshme, jo tipike, për të cilët do të jetë e paarsyeshme përjashtimi nga një leje e përkohëshme;
- b. aeroplanet nga operimi i të cilëve për qëllime modifikimi, riparimi ose mirëmbajtjeje nuk ka përfitime financiare.

KREU III SANKSIONET

Neni 7

Kundërvajtjet dhe sanksionet

Shkeljet e mëposhtme, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative ndërkohë që për shmangjet nga përcaktimet referuar pikave 1 dhe 2 të nenit 5 të këtij vendimi zbatohen parashikimet e nenit 142, gërma (dh) e Ligjit 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

MINISTRI


Lefer KOKA

